REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORTI
I
VEPRIMTARISË
PËR
VITIN 2024

Maliq, Shkurt 2025

Raportimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është hartuar konform kërkesave të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 100/2016 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 4, datë 10.01.2020 "*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*", Manuali i Auditimit të Brendshëm i ndryshuar, kapitulli i IV-t, pika 4.3 "*Raportimi vjetor i veprimtarisë së NjAB tek titullari i subjektit publik dhe Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm*". Për vitin 2024 në zbatim të Standartit 2450 "*Opinionet e Përgjithëshme Standartet Ndërkomtare për PraktikënProfesionale të Auditimit të Brendshëm*" **po ju japim dhe Opinionin e Përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.**

Më hollësisht po trajtojmë raportimin sipas strukturës së mëposhtëme.

Në hartimin e raportit të veprimtarisë të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, janë marrë në konsideratë të gjitha ndryshimet eventuale si në strukturën e institucionit dhe gjetjet dhe rekomanduimet e dhëna nga Auditimi i Jashtëm (KLSH). Vëmendje e veçantë nga Auditimi i Brendshëm po i kushtohet ndryshimeve strukturorë të ndodhura në institucion gjatë muajve Janar-Dhjetor 2024, pasi për herë të parë në Bashkinë Maliq ka ndryshime rrënjësore në strukturë duke u krijuar një Drejtori Mbështetëse me strukturë, nipt dhe buxhet më vete.

STRUKTURA E RAPORTIT VJETOR 2024 E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA MALIQ.

I. Përmbledhje Ekzekutive

II. Baza Ligjore

III. Organizimi

- Misioni i auditimit të brendshëm

- Organizimi i NJAB

IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

- Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese
- Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve
- Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre
- Gjetjet kryesore sipas sistemeve
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

- Çështjet e dërguara për investigim

V. Rekomandimet.

- Rekomandimet e propozuara
- Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit

VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë

VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese

- Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NjAB
- Kapacitetet audituese
- Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve
- Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve

VIII. Konkluzione

- Konkluzione mbi problematikën e punës audituese.
- Prioritetet për vitin e ardhshëm

IX. Auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 .

X. Opinioni i Përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

I. Përmbledhje Ekzekutive

Funksioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e lartë të bashkisë (Kryetarin e Bashkisë) dhe subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së NjAB-së për vitin 2024, janë detajuar e analizuar në këtë raport dhe në pasqyrat e raportimit të veprimtarisë vjetore.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq, gjatë vitit 2024 ka ushtruar veprimtarinë e saj në 9 subjekte, nga 9 subjekte të planifikuara, **realizimi i planit është 100%.**
Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2024 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 5512/1 prot, datë 12.10.2023 dhe nga ku rezulton se Plani i Angazhimeve të NjAB për vitin 2024 ka synuar për të audituar gjithsej 9 subjekte.
Plani i mësipërm është dërguar rregullisht në
Në muajin Tetor 2024 lindi nevoja e ndryshimit të Planit të Auditimit për shkak të një auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit konkretisht me shkresën nr 1086/1, ku një ndër pikat më kryesore të këtij auditimi ishte Drejtoria e të Ardhurave. Plani i angazhimeve për vitin 2024 me ndryshimet, u hartua i ri dhe u miratua nga Kryetari i Bashkisë me Shkresën nr. 4429/1, shkresë e cila është dërguar dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Në planin e ri të ndryshuar u hoq nga planifikimi subjekti Drejtoria e të Ardhurave dhe u zëvendësua me subjektin Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Plani vjetor i ndryshuar u realizua 100%.
Është planifikuar dhe kryer auditimi **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna** në subjektet e audituara gjatë vitit, ç'ka lidhet dhe me performancën e veprimtarisë audituese. Në vitin 2024 një vëmendje e veçantë nga NjAB iu kushtua dhe **auditimit mbi detyrimet e prapambetura** për të cilat janë future në programet tona të përvitëshme..

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara është vlerësuar në disa subjekte një nivel i lartë risku në sistemet e menaxhimit financiar, menaxhimin e aktiveve, në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Konkretisht në përfundim të 9 auditimeve të planifikuara na rezultojnë 2 subjekte me risk të lartë,6 subjekte me risk të mesëm dhe 1 subjekt me risk të ulët.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve, me synim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Theksojmë se rekomandimet, për 9 subjektet e audituara janë gjithsej **72** të ndara në: **rekomandime me prioritet të lartë 22, rekomandime me prioritet të mesëm 40** dhe **rekomandime me prioritet të ulët 10. Të gjitha rekomandimet e dhëna janë pranuar nga subjektet audituese.**

Për t'ju dhënë rëndësinë e duhur rekomandimeve të NjAB nga ana e institucionit "Bashkia Maliq" është ndjekur dhe praktika që në përfundim të çdo auditimi, rekomandimet e lëna nga NjAB ju jepen subjekteve në formën e një urdhëri të veçantë të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë. Gjatë vitit 2024 nga ana e Kryetarit të Bashkisë janë hartuar gjithësej 3 urdhëra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NJAB, të cilat ju janë adresuar të gjitha subjekteve të bashkisë që kanë qënë subjekt auditimi dhe dhe ju adresohet rekomandimi i dhënë dhe 4 urdhëra janë në process hartimi nga zyra juridike. Nuk është hartuar udhër vetëm për dy auditime e konkretisht për Zbatimin e detyrave të lëna nga NJAB dhe Detyrimet e Prapambetura, pasi për detyrat janë hartuar urdhëra më parë dhe për detyrimet e prapambetura ka një program dhe grafik të miratuar për shlyerjen e tyre.

Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve është ende për të dëshiruar. Konkretisht për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 72 rekomandime dhe deri më datën 10.02.2025 rezulton se 27 rekomandime janë zbatuar, 30 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 15 rekomandime janë të pa zbatuara.
Zbatimi i tyre është rreth 37.5 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm. Më datën 10 Prill 2025 do tju raportojmë zyrtarisht për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lënë për vitin 2024, kjo në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 42, datë 27.10.2020.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se për çdo rast gjetje është dhënë dhe rekomandimi përkatës, për shkeljet e konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

Struktura e miratuar e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq është e përbërë nga 3 veta. Gjatë vitit 2024 struktura ka funksionuar si sektor me 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë.
Nga 3 punonjës gjithsej 2 janë të certifikuar dhe 1 është i pa certifikuar. Theksojmë se mos hapja e kurseve të certifikimit nga Ministria e financave përbën pengesën kryesore që audituesi nuk është certifikuar.

II. Baza Ligjore

Auditimi i brendshëm ka një bazë ligjore dhe proceduriale e cila përfaqësohet nga: Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre.
Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është ligji nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".

Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.
Akte të tjera ligjore e nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2012 "*Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar me VKM nr. 353, datë 11.05.2016.

- Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "*Për Miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik*".
- Urdhër nr. 4, datë 10.01.2020 i Ministrit të Financave "*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*".

- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 42, datë 27.10.2020 "*Mbi ndjekjen e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*".

Ligji organik i pushtetit vendor dhe gjithë legjislacioni në fuqi për veprimtarinë që kryejnë drejtoritë dhe sektorët e bashkisë.
Aktet nënligjore në zbatim të legjislacionit të mësipërm.

III. Organizimi

Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

1. Mbështetur menaxhimin e organizatës publike për arritjen e objektivave.

2. Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve, bazuar në standartet profesionale të miratuara.

3. Ngritur nivelin profesional të audituesve.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq për periudhën Janar-Shtator 2024 mbulon me auditim gjithsej 27 subjekte si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i subjektit
1	Zyra e Integrimit Europian dhe Kordinimit të Ndihmës të Huaj.
2	Sektori i Rekreacionit, Turizmit dhe Rinisë
3	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
4	Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore
5	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike
6	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
7	Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT) + Mjedis
8	Sektori i Emergjencave Civile
9	Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
10	Sektori i Teknologjisë të Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun
11	Njësia Administrative Pojan
12	Njësia Administrative Vreshtas
13	Njësia Administrative Libonik
14	Njësia Administrative Pirg
15	Njësia Administrative Gorë
16	Njësia Administrative Moglicë
17	Sektori i Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Artit
18	Sektori Mekanik
19	Sektori i Shërbimit Publik
20	Sektori Pyje-Kullotave
21	Sektori iRrugëve Rurale
22	Sektori i Ujitje-Kullim
23	Policia Bashkiake
24	Sektori e Bujqësisë dhe Mbrojtjes të Konsumatorëve
25	Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
26	Kombinati i Sheqerit Sh. a. Maliq
27	Klubi i Futbollit Maliq Sh. a.

Për periudhën Shator –Dhjetor bazuar në strukturën e re të ndryshuar ishin objket auditimi 22 subjekte si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i subjektit
1	Zyra e Integrimit Europian dhe Kordinimit të Ndihmës të Huaj.
2	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
3	Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore
4	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike
5	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit & Zhvillimit të Territorit
6	Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve
7	Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT) + Mjedis
8	Sektori i Emergjencave Civile
9	Drejtoria e Shërbimeve sociale Arsimit dhe shëndetësisë.
10	Sektori i IT dhe Marrëdhënieve me Publikun
11	Policia Bashkiake
12	Gjendja Civile
13	Mbrojtja nga Zjarri & Shpëtimi
14	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
15	Kombinat Sheqeri Sh.a Maliq
16	Shoqata Sportive Klubi i Futbollit Maliq
17	Njësia Administrative Pojan
18	Njësia Administrative Vreshtas
19	Njësia Administrative Libonik
20	Njësia Administrative Pirg
21	Njësia Administrative Gorë
22	Njësia Administrative Moglicë

Organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq është e organizuar në nivel sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Sektori ka varësi direkte nga Kryetari i Bashkisë Maliq.

Nga tre audituesit janë të certifikuar 2 prej tyre dhe i treti është në pritje për të aplikuar për certifikim, gjithashtu kanë ndjekur dhe trajnimin e detyrueshëm, bazuar në standartet ndërkombëtare dhe nenit 5 të Rregullores "*Trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve*

të brendshëm në sektorin publik" miratuar me Urdhërin nr. 260, datë 27.10.2020 "*Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhërin nr. 3, datë 08.01.2016 "Për miratimin e rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik*".

Struktura ka funksionuar e plotë.

Përbërja profesionale e audituesve të brendshëm është – **Financier i** Lartë (Përgjegjësi i Sektorit)**, Financë-Kontabilitet** (Audites) **dhe Menaxhim-Marketing**(Audites).

Sipas **eksperiencës në punë** si audites të brendshëm përbërja jepet në tabelën më poshtë**:**



IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Në planin e vitit 2024 janë programuar për auditim 9 subjekte dhe në fakt janë realizuar 9 auditime, brenda vitit. Realizimi i planit të auditimit përsa i përket numrit total është në masën 100 %.

Në skemën më poshtë jepet realizimi i planit vjetor për vitin 2023 e 2024.

Sqarojmë se në dosjet e auditimeve të vitit 2024 vetëm një subjekt u evadua raporti përfundimtar në muajin Janar 2025.



Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve

Për vitin 2024 **janë programuar 9 misione auditimi** nga të cilat janë: 3 auditime përputhshmërie, 1 auditim (Financiar) 4 auditime (Të Kombinuara) dhe 1 auditim tematik. Për vitin 2024, u audituan subjektet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit(Detyrimet e prapambetura,veprimet e kryera me arkë, bangë,magazinë), Zbatimi i detyrave të lëna nga NjAB në vitin 2023, Njësia Administrative Pirg,Sektori Rekreacionit Turizmit dhe Rinisë,Klubi i Fubollit Maliq, Njësia Administtrative Moglicë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe Drejtoria e Ujitje-Kullimit.
Për vitin 2024, auditimet me peshë të rëndësishme kanë qenë Drejtoria e Shërbimeve Publike.Drejtoria e Ujitje Kullimit, Njësia Administrative Pirg të cilat kanë dhe pjesën më të madhe të gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna nga NjAB.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në fazën e planifikimit Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë mbi të cilat është bërë dhe plani vjetor i punës. Nga misionet e ushtruara në subjektet e

audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.
Bazuar në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2024 vlerësojmë me risk të lartë 2 subjekte e konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ujitje-Kullimit. Konkretisht me risk të lartë paraqitet planifikimi, evidentimi dhe arkëtimi tarifa e ujit të vaditjes, pasi duhet parë mundësia e ndryshimit të mënyrës së arkëtimit e cila deri tani kryhet në masë të madhe nga arkëtarët shëtitës në terren.
Për subjektet me risk të lartë kemi planifikuar dhe misione auditimi për periudhat në vazhdim. Konkretisht në vitin 2025 kemi planifikuar për Auditim Drejtorinë e të Ardhurave ku do të shikohen me prioritet dhe njësitë administrative me rik të lartë.
Nga auditimi është konstatuar se subjektet e audituara, kanë raportuar brenda afatit 30 ditor dhe kanë plotësuar dhe planin e veprimit.
Për të gjitha auditimet e realizuara në përfundim të raportit final, për rekomandimet e AB është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë urdhër i veçantë për zbatimin e tyre.

Raportimi për masat e marra nga ana e titullarëve të subjekteve të audituara është i mangët në caktimin e afateve dhe përgjegjësave gjithashtu dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Një panoramë më të plotë dhe më të detajuar të dhënat janë të referuara në pasqyrën nr. 3, bashkëngjitur këtij raporti "*Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit për vitin 2024*".

Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Në subjektet e audituara janë marrë në analizë gjetjet e konstatuara, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe janë lënë rekomandimet për menaxhimin e riskut në të ardhmen. Janë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi i 9 subjekteve lidhen kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të kontrollit të brendshëm, në sistemin e programimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat lokale, menaxhimin e fondeve nga donatorët e huaj, shpenzimeve të realizuara nga të cilat mund ti përmendim si më poshtë;

1-Në sistemin e të ardhurave

a- Janë konstatuar shkelje në *fushën e Tatim-Taksave (Mungesë të Ardhurash).*
Nga auditimet ka rezultuar që në disa raste nuk zbatoheshin tarifat e vendosura në paketën fiskale duke bërë devijime për tarifat mbi aktete duke arkëtuar në disa raste

dhe më tepër nga kufijtë e vendosur me vendim Këshillit Bashkiak. Konkretisht në Njësinë Administrative Pirg ishin arkëtuar padrejtësisht 25.400 lekë në 60 rate, në dëm të taksapaguesve.

Nga auditimet e kryera në total rezultojnë mungesë të ardhurash në vlerën 8.984.000, këto kryesisht rezultojnë të ardhur të munguara nga mosarkëtimi kryesisht i tarifës së ujit të vaditjes nga Drejtoria e Bordit të Kullimit dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe nga Klubi i furbollit për biletat e sportit.

b-Janë konstatuar shkelje në fushën e shpenzimeve materiale.

Nga shpenzimi i materialeve sipas fletë-daljeve ka rezultuar shkelje e disiplinës financiare pa dëm ekonomik pasi nuk ishte zbatuar plotësisht urdhëri nr 67 i Kryetarit të Bashkisë për shpenzimet material që realizophen nga magazine e bashkisë.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i veprimtarisë në 9 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

- Ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.
- Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.
- Mospërshtatja e ndryshimeve në strukturë me rregulloren ekzistuese.

Në çdo raport final nga ana e audituesve është analizuar dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm dhe i është raportuar Titullarit të Institucionit lidhur me funksionimin e tij dhe dobësitë e mangësitë e vërejtura. Në përfundim të çdo auditimi nga ana e përgjegjësit të NJAB është përgatitur një Memo për Titullarin e Institucionit ku dhe i jepet vlerësimi për sistemin e kontrollit të brendshëm të subjektit audituës.

Çështjet e dërguara për investigim

Gjatë vitit 2024 nuk ka patur asnjë çështje për investigim.

V. Rekomandimet

- Rekomandimet e propozuara

Nga ana e audituesve për çdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen. Për 9 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 72 rekomandime afërsisht 8 rekomandime për subjekt.**

Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

Nga ana e NJAB rekomandimet janë dhënë të plota, të qarta, të adresuara dhe synojnë përmirësimin e veprimtarisë dhe përformancës së kontrollit të brendshëm.

- Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit

Në fillim të vitit 2025 bazuar në planin e punës është kryer dhe auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2024. Sqarojmë se në të gjitha subjektet e audituara një pikë e programit të punës ka qenë zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se ka rekomandime që nuk janë zbatuar.
Konkretisht deri më datën 10 shkurt 2025, nga 72 rekomandime të dhëna e të pranuara, janë zbatuar plotësisht 27 rekomandime, janë në proces zbatimi 30 rekomandime dhe kanë mbetur gjithsej 15 rekomandime të pa zbatuara për vitin 2024.
Duhet një vëmendje më e madhe nga ana e subjekteve të audituara lidhur me rëndësinë dhe përgjegjshmërinë që duhet të tregojnë lidhur me rekomandimet e AB.

Shkaqet e moszbatimit të rekomandimeve të lëna janë për arsye:

- Të ndryshimit të stafit, largimit nga puna të personave për të cilët janë lënë rekomandime.

- Mangësi në njohjen dhe azhornimin me aktet në fuqi.

- Ristrukturimi i disa drejtorive të cilat u grupuan në Sektorin Mbështetës duke kaluar me nipt dhe llogari më vete.

VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë

Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit ka kryer dhe rishikimin e cilësisë së auditimeve të kryera. Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një

siguri të arsyeshme në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standarteve të tjera të zbatueshme.
Për auditimet e kryera në vitin 2024 është plotësuar:
-Aneksi 1.1: Lista e kontrollitpër monitorimin e brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm-Audituesi i brendshëm (Standarti 2200-2400).
-Aneksi 1.2:Lista e kontrollit për monitorimin e brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm-Përgjegjësi I grupit të auditimit (Standarti 2200-2500-Përgjegjësi i grupit të auditimit).
-Aneksi 1.3:Lista e kontrollit për monitorimin e brenshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm-Drejtuesi i NJAB (Standarti 2200-2500Zonat e përgjithëshme-Drejtuesi i NJAB).
-Aneksi nr 2:Lista e kontrollit për të vlerësuar cilësinë e kritereve gjatë vlerësimit periodic të cilësisë së brendëshme.
-Aneksi 3: Model studimi i subjektit të audituar-Fecdback.

VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese

- Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NjAB.

Sektori i Auditimit të Brendshëm është i përbërë nga 3 auditues dhe ushtron veprimtarinë e tij për auditimin e Bashkisë Maliq, janë gjithsej 27 subjekte për tu audituar, nga Shtatori deri në Dhjetor numuri i subjekteve auditees u reduktua në 22 për shkak të ristrukturimit.
Për planifikimin e saktë të subjekteve që do të auditohen kemi marrë parasysh riskun, frekuencën e auditimit dhe auditimet e kryera nga KLSH.

-Kapacitetet audituese

Struktura e miratuar e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq është e përbërë nga 3 vetë**, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist audit.**

Gjatë vitit 2024 struktura ka qenë e plotë.

Nga 3 auditues 2 prej tyre janë të certifikuar "*Auditues të Brendshëm në sektorin publik*", dhe kualifikuar dhe trajnuar rregullisht.

Niveli profesional i audituesve është ekonomist.

Eksperienca në punë e audituesve është 16 vjet përgjegjësi, 5 vite pune një specialisti, dhe 2 vit pune specialisti tjetër.

- Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve

Gjatë vitit 2024 nga audituesit është ndjekur trajnimi në fushën e auditimit të brendshëm të kryer nga NJQH/AB.

-Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve

Gjatë vitit 2024, burimet njerëzore janë menaxhuar rregullisht duke kryer auditimet e planifikuara, si dhe zbatuar ndryshimet në planin e angazhimeve. Në shpenzimet e realizuara nga ky sektor futen vetëm pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe shpenzimet për materiale zyre e kancelari si dhe shpenzimet për trajnimet e zhvilluara.

VIII. Konkluzione

-Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Një maksimizim i funksionit të auditimit të brendshëm do të thotë rezultate, përmirësim dhe vlerë. Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme.

Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka impakt të drejpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet ku ai funksionon. Duke mbështetur menaxhimin me vlerësime objektive dhe të pavarura dhe për më tepër duke ofruar rekomandime efektive auditimi i brendshëm shton vlerën e vetë auditimit e si rrjedhojë dhe të subjektit të audituar.

1. Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut nuk janë praktika të zakonshme të punës audituese, për shkak dhe të kufizimit në kohë për kryerjen e një auditimi.

2. Eksperienca e pakët e punës së specialistëve si në auditim dhe eksperiencën totale të punës, i strukturës së auditit për një periudhë të gjatë kohe ndikon në realizimin e objektivave.

Sa më sipër janë kufizime që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë së auditimit.

-Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm kemi si prioritet:

1- Rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet forcimit të procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë.

2- Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve, me qëllim zbatimin 100% të tyre nga njësitë e audituara.

3- Kërkimi nga titullarët e institucioneve publike të përgatitin në kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditimi i brendshëm dhe të raportojnë periodikisht deri në zbatimin e plotë të tyre.

4- Rritja e aftësisë së audituesve nëpërmjet trajnimit në fusha konkrete sipas nevojave.

IX. Auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023.

Në fillim të vitit 2024 me program të veçantë angazhim auditimi u krye nga struktura e NjAB auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023. Ky auditim përfshin periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023. Në fillim të vitit 2025 ka filluar auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2024, i cili është në proces auditimi dhe evadimi i tij bëhet brenda muajit Mars 2025.Lidhur me këtë auditim iu bëjmë me dije se në përfundim bazuar në gjetjet janë dhënë 5 rekomandime. Më poshtë po japim gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet e dhëna nga NjAB për vitin 2023.

- **Gjetje Nr.1:** Nga auditimi rezultoi se nga gjendja në datën 01.01.2023 Bashkia Maliq ka detyrime të prapambetura në vlerën 10,618,288, lekë për faturat e prera dhe të palikuiduara brenda afatit 60-ditor. Për periudhën Janar-Prill 2023 rezulton se vlera e detyriimeve është 18,844,408 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura është rritur me 8,226,120 lekë, për shkak të detyrimeve të reja të krijuara dhe atyre të palikuiduara nga viti 2022. **Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Maliq të merren të gjitha masat që të ndiqen në vijmësi detyrimet e prapambetura dhe të bëhen përpjekje për shlyerjen e detyrimeve ekzistuese.

- **Gjetje Nr.2:** Në datën 30 Prill 2023 rezulton se Totali i detyrimeve të prapambetura kap vlerën 18,844,408 lekë që i korrespondon kategorisë Shpenzime kapitale për vlerën 18,844,408, për 1 subjekt privat.

Rekomandimi: Të bëhen të gjitha përpjekjet që të likujdohen detyrimet e prapambetura në vijimësi dhe të mos krijohen detyrime të reja të prapambetura.

- **Gjetje Nr.3:** Nga auditimi rezultoi se për periudhën Maj- Gusht 2023 shuma e detyrimeve të prapambetura ishte rritur për shkak të faturave ekzistuese të palikuiduara dhe atyre të reja të krijuara për këtë periudhë. Në krahasim me 4 mujorin e parë të 2023 rezulton që detyrimet janë rritur me 18,402,320 lekë ose 49%. Në datën 31 Gusht 2023 Totali i detyrimeve të prapambetura kap vlerën **37,246,728** që i korrespondon kategorisë Shpenzime kapitale për vlerën **37,246,728**, për 1 subjekt privat..
  Rekomandimi: Të merren masa për likuidimin e detyrimeve të ngelura dhe të vendosen në prioritetet e likujdimit për periudhën Shtator -Dhjetor 2023.

- **Gjetje Nr.4:** Nga auditimi rezulton se për periudhën Shtator-Dhjetor 2023 detyrimet e prapambetura kapin vlerën 45,033,964,lekë të cilat i përkasin kategorisë Spenzime kapitale me vlerë 45,033,964 lekë. Nga analiza e bëra nga auditmi rezulton se vlera e detyrimeve në krahasim me 4 mujorin e kaluar është rritur me 7,787,236 lekë ose 21%.
  Rritja ka erdhur si pasojë edhe e faturave të reja të krijuara dhe e detyrimeve ekzistuese të palikuduara, konkretisht; Subjektit Vashtmia për objektin *"Sistemim Asfaltim Gryka Vloçisht-Drithas"* vlera 9,350,980 lekë.
  Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së financës dhe të Buxhetit detyrimet e prapambetura të palikuduara të shikohen me përparësi dhe të vendosen për shlyerje në prrioritetet e periudhës aktuale.
  Mbetet detyrë në vijim likuidimi përfundimtar i detyrimeve të prapambetura të ngelura.

- **Gjetje Nr.5:** Nga auditimi rezultoi se në datën 01.01.2023 detyrimet e prapambetura për pagesën e lindjeve në masën 5,000 lekë/për lindje ishin në vlerën 5,620,000 lekë , gjatë vitit 2023 nuk ishin çelur dhe likujduar fonde për këto detyrime. Mbetet për likuidim si detyrime të prapambetura vlera prej 5,620,000 lekë për 1124 raste lindje. Rezulton se për vitin 2023 lidhur me këto detyrime nuk është bërë përpjekja e duhur për financimin e tyre dhe mbetet detyrë prioritare financimi dhe likuidimi i tyre pasi janë detyrime të shumë viteve më parë.

  Rekomandimi: Të vazhdojnë përpjekjet ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile Tiranë, deri në likujdim të plotë të tyre.

X. Opinioni mbi Vlerësimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Në zbatim të shkresës tuaj nr. 675 prot datë 16.01.2025, *"Mbi raportimin e veprimtarisë së NJAB-së për vitin 2024"*, si dhe bazuar në standartin nr 2450 "Opinonet e përgjithshme Standartet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm" po japim opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e Sistemit të Kontrollit të brendshëm.
Për dhënien e ktij opinioni jemi bazuar në strategjinë, objektivat, dhe rrisqet e Bashkisë si dhe në auditimet e kryera gjatë viteve të mëparshme dhe vitit të kaluar 2024, jemi mbështetur dhe në gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH.
Bazuar në sa thamë më sipër si dhe në pritshmëritë e menaxhimit të lartë opinioni jonë si strukturë audituese për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm është si më poshtë:

Opinion i Vlerësimit të Sistemit të Kontrollove të Brendshëm	**Përshkrimi i Opininit Baza e Opinionit**
Niveli 2-Sistem Pjesërisht Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon evektivisht/mirë, por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave". **E verdhë**	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon në mënyrë ekfektive, por u gjetën disa mangësi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirsime në disa drejtime.

Afrim Beqiraj

Përgjegjës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm